

**VENDIM**  
**Nr. 195, datë 18.9.2024**

**MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “AYEN AS ENERGJI” SHA,  
PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN E ASETEVE  
FIKSE TË SAJ**

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa “a”, dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, germa “b” dhe 11 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.9.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1774/7 prot., datë 18.9.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Ayen As Energji’ sh.a., për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve të paluajtshme të saj”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Ayen As Energji” sh.a. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet “Ura e Fanit”, “Fangu” dhe “Peshqesh”, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 32, datë 4.3.2015, modifikuar me vendimin e Bordit nr. 128, datë 16.8.2017.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1174 prot., datë 19.8.2024, shoqëria ka paraqitur aplikimin për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve fikse të saj, për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj marrëveshjes së kredisë sindikale, të nënshkruar me “Raiffeisen Bank” sh.a., “OTP Bank” sh.a., “Intesa SanPaolo Bank” sh.a. dhe “Tirana Bank” sh.a., ku agjent i kredisë dhe i kolateralit është zgjedhur “Raiffeisen Bank” sh.a.

- Me vendimin nr. 178, datë 3.9.2024, ERE vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve fikse të saj dhe me shkresën nr. 1174/1 prot., datë 4.9.2024, ERE njoftoi shoqërinë për këtë vendim dhe i evidentoi dokumentacionin që nevojitet të plotësohet.

- ERE ka njoftuar MIE-n për fillimin e kësaj procedure me shkresën nr. 1878 prot., datë 6.9.2024.

- Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1174/5 prot., datë 11.9.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues për këtë aplikim.

- Nga analiza përfundimtare e aplikimit rezulton se shoqëria “Ayen As Energji” sh.a. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar nga neni 7, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i” dhe “j”; si dhe pikat 3, 4, dhe 6 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016.

- Duke qenë se në marrëveshjen e hipotekës dhe atë të barrës siguroese përcaktohet se këto kolaterale të vendosura mbi pasuritë dhe asetet e paluajtshme të shoqërisë janë të radhës së dytë, pasi mbi to është vendosur tashmë një kolateral i radhës së parë për të siguruar një detyrim tjetër që shoqëria ka ndaj të tretëve, si rrjedhojë autorizimi i ERE-s për transferimin (nëpërmjet vendosjes së hipotekës dhe barrës siguroese) të aseteve fikse të shoqërisë do të jetë i radhës së dytë.

- Vlerësohet të sqarohet se dhënia e autorizimit nga ERE nuk e çliron shoqërinë nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve/institucioneve të tjera apo palëve të treta për këtë transferim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe/institucione.

- Përveç sa më sipër, për shkak të natyrës që ka vendosja e një mjeti të tillë mbi asetet e shoqërisë për garantimin e detyrimit përkatës nga i licencuari, vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që të njoftojë menjëherë ERE-n për heqjen e barrës siguroese mbi asetet e saj ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

## VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “Ayen As Energji” sh.a. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së hipotekës dhe barrës siguruese të radhës së dytë) mbi asetet fikse të saj, për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj marrëveshjes së kredisë sindikale, të nënshkruar me “Raiffeisen Bank” sh.a., “OTP Bank” sh.a., “Intesa SanPaolo Bank” sh.a. dhe “Tirana Bank” sh.a., ku agjent i kredisë dhe i kolateralit është “Raiffeisen Bank” sh.a. (sipas listës bashkëlidhur).

2. Dhënia e autorizimit sipas përcaktimeve të pikës 1 nuk e çliron shoqërinë “Ayen As Energji” sh.a. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve/institucioneve të tjera apo palëve të treta për këtë transferim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe/institucione.

3. Shoqëria “Ayen As Energji” sh.a. të njoftojë menjëherë ERE-n për heqjen e hipotekës dhe të barrës siguruese mbi asetet fikse të saj, që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar, ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

4. Ky vendim është objekt rishikimi, në rast se shoqëria dokumenton heqjen e hipotekës dhe të barrës siguruese të radhës së parë të vendosur mbi asetet e saj.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Ayen As Energji” sh.a. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
**Petrit Ahmeti**

**Lista e pasurive dhe aseteve fikse të shoqërisë “AYEN AS ENERGJI” sh.a.**

**HEC PESHQESH**

**Vlera totale: 12,700,874.32 euro:**

1. Turbina vertikale e tipit Francis-1 me nr. serial F680, prodhuar nga CKD Holding – Republika Ceke në vitin 2014 e vendosur në sallën e turbinave të termocentralit duke përfshirë të gjitha pjesët plotësuese të turbinës si kutia spirale, tuba rryme, nyje çmontimi, etj. Me vlerë 1,350,000 euro.
2. Turbina vertikale e tipit Francis-2 me nr. serial F681, prodhuar nga CKD Holding – Republika Ceke në vitin 2014 e vendosur në sallën e turbinave të termocentralit duke përfshirë të gjitha pjesët plotësuese të turbinës si kutia spirale, tuba rryme, nyje çmontimi, etj. Me vlerë 1,350,000 euro.
3. Valvula hyrëse e tipit Butterfly(Flutur)-DN2300-PN12/16 me nr. serial 038-14, prodhuar nga CKD Holding – Republika Ceke në vitin 2014 me vendodhje në dhomën e valvulave brenda termocentrali. Me vlerë 375,000 euro.
4. Valvula hyrëse e tipit Butterfly(Flutur)-DN2300-PN12/16 me nr. serial 039-14, prodhuar nga CKD Holding – Republika Ceke në vitin 2014 me vendodhje në dhomën e valvulave brenda termocentrali. Me vlerë 375,000 euro.
5. Valvula sigurie e tipit Butterfly(Flutur)-DN3200-PN10 me nr. serial 040-14, prodhuar nga CKD Holding – Republika Ceke në vitin 2014 e vendosur në dhomën e valvulave të sigurisë midis tunelit ballor dhe ate uJOR. Me vlerë 450,000 euro.
6. Të gjitha pajisjet ndihmëse duke përfshirë pompat, shkëmbyesit e nxehtësisë, filtrat, valvulat e kontrollit të furnizuar nga CKD Holding – Republika Ceke në vitin 2014 të vendosura në dyshtemenë e turbinës së termocentralit. Me vlerë 700,000 euro.
7. SINCHRONOUS-PSA-1800-L/4 tip GJENERATOR-1 me nr.3010000469, prodhuar nga INDAR – Spanjë në vitin 2014 me vendodhje në sallën e gjeneratorit të termocentralit duke përfshirë të gjitha pjesët e këmbimit. Me vlerë 1,500,000 euro.
8. SINCHRONOUS-PSA-1800-L/4 tip GJENERATOR-2 me nr.3010000470, prodhuar nga INDAR – Spanjë në vitin 2014 me vendodhje në sallën e gjeneratorit të termocentralit duke përfshirë të gjitha pjesët e këmbimit. Me vlerë 1,500,000 euro.
9. Transformator i fuqisë i tipit Oil Immersed (IEC 60076) me nr.PA011-01, prodhuar nga ALSTOM – Turqi në vitin 2014 e vendosur pranë centralit të energjisë elektrike duke përfshirë të gjitha pjesët e nevojshme rezervë. Me vlerë 633,227.81 euro.
10. Transformator i Shërbimit të Stacionit të tipit të thatë-1 (IEC 60076-11:2004) me nr. KT-14-3277, prodhuar nga ELTAS – Turqi në vitin 2014 e vendosur në katin e hyrjes së termocentralit. Me vlerë 14,436.72 euro.
11. Transformator i Shërbimit të Stacionit të tipit të thatë-2 (IEC 60076-11:2004) me nr. KT-14-3278, prodhuar nga ELTAS – Turqi në vitin 2014 e vendosur në katin e hyrjes së termocentralit. Me vlerë 14,436.72 euro.

12. Gjenerator Dizel (AD 330-ECO38-2LN/4) me nr. EDIOC 435489, prodhuar nga AKSA – Turki në vitin 2014 e vendosur në katin e hyrjes së termocentralit. Me vlerë 18,500 euro.
13. Sistemi i mbrojtjes nga zjarri i furnizuar nga Alstrom Turki në vitin 2014 i vendosur në godinën e kontrollit të termocentralit. Me vlerë 74,817.46 euro.
14. Pajisjet e tensionit të mesëm të furnizuara nga Alstrom Turki në vitin 2014 të vendosura në sallën e tensionit të mesëm të termocentralit. Me vlerë 462,897.72 euro.
15. Ndërprerës 220kV prodhuar nga Alstrom Francë në 2014, SN AN71/2014 e vendosur në sallën GIS të termocentralit duke përfshirë të gjitha pjesët e nevojshme rezervë. Me vlerë 1,975,705.17 euro.
16. Sistemi lokal i kontrollit të procesit i furnizuar nga Alstrom Turki në 2014 i vendosur në sallën e gjeneratorit, sallën e turbinës dhe dhomën DCS të termocentralit. Me vlerë 967,852.44 euro.
17. Sistemi i sondës së nivelit i furnizuar nga Alstrom Turki në 2014 i vendosur në rezervuarin, bazën e vendosjes, rezervuarin e mbitensionit dhe kanalin e ujit të bishtit të termocentralit. Me vlerë 19,056.55 euro.
18. Sistemet ndihmëse AC dhe DC të furnizuara nga Alstrom Turki në 2014 të vendosura në dhomën AC/DC të termocentralit duke përfshirë të gjitha pjesët e nevojshme rezervë. Me vlerë 594,942.33 euro.
19. Pajisjet e dhomës së kontrollit të furnizuara nga Alstrom Turki në vitin 2014 të vendosura në dhomën e kontrollit të termocentralit. Me vlerë 167,627.08 euro.
20. Pajisje telekomunikacioni dhe telembrojtjeje të furnizuara nga Alstrom Turkey në vitin 2014 të vendosura në sallën GIS të termocentralit. Me vlerë 157,374.32 euro.

## HEC FANG

### **Vlera totale: 16,215,706.08 euro:**

1. Turbina vertikale e tipit Francis-1 me nr. serial F682, prodhuar nga CKD Holding – Republika Çeke në vitin 2015 e vendosur në sallën e turbinave të termocentralit duke përfshirë të gjitha pjesët plotësuese të turbinës si kutia spirale, tuba rryme, nyje çmontimi, etj. Me vlerë 1,445,173.64 euro.
2. Turbina vertikale e tipit Francis-2 me nr. serial F683, prodhuar nga CKD Holding – Republika Çeke në vitin 2015 e vendosur në sallën e turbinave të termocentralit duke përfshirë të gjitha pjesët plotësuese të turbinës si kutia spirale, tuba rryme, nyje çmontimi, etj. Me vlerë 1,445,173.64 euro.
3. Valvula hyrëse e tipit Butterfly(Flutur)-DN2500-PN12/16 me nr. serial 044-15, prodhuar nga CKD Holding – Republika Çeke në vitin 2015 me vendodhje në dhomën e valvulave brenda termocentrali. Me vlerë 383,000 euro.
4. Valvula hyrëse e tipit Butterfly(Flutur)-DN2500-PN12/16 me nr. serial 045-15, prodhuar nga CKD Holding – Republika Çeke në vitin 2015 me vendodhje në dhomën e valvulave brenda termocentrali. Me vlerë 383,000 euro.

5. Valvula sigurie e tipit Butterfly(Flutur)-DN4500-PN12 me nr. serial 046-15, prodhuar nga CKD Holding – Republika Ceke në vitin 2015 e vendosur në dhomën e valvulave të sigurisë midis tunelit ballor dhe ate uJOR. Me vlerë 684,000 euro.
6. Të gjitha pajisjet ndihmëse duke përfshirë pompat, shkëmbyesit e nxehtësisë, filtrat, valvulat e kontrollit të furnizuar nga CKD Holding – Republika Ceke në vitin 2014 të vendosura në dyshtemenë e turbinës së termocentralit. Me vlerë 740,200 euro.
7. SINCHRONOUS-PSA-2500-X/16 tip GJENERATOR-1 me nr.3010000473, prodhuar nga INDAR – Spanjë në vitin 2015 me vendodhje në sallën e gjeneratorit të termocentralit duke përfshirë të gjitha pjesët e këmbimit. Me vlerë 2,313,000 euro.
8. SINCHRONOUS-PSA-2500-X/16 tip GJENERATOR-2 me nr.3010000474, prodhuar nga INDAR – Spanjë në vitin 2015 me vendodhje në sallën e gjeneratorit të termocentralit duke përfshirë të gjitha pjesët e këmbimit. Me vlerë 2,313,000 euro.
9. Transformator Power Immersed i tipit Oil Immersed (IEC 60076) me nr.PA012-01, prodhuar nga ALSTOM – Turqi në vitin 2015 e vendosur pranë centralit të energjisë elektrike duke përfshirë të gjitha pjesët e nevojshme rezervë. Me vlerë 450,000 euro.
10. Transformator Power Immersed tip 2 (IEC 60076) me nr. PA012-02, prodhuar nga ALSTROM – Turqia në vitin 2015 e vendosur pranë termocentralit duke përfshirë të gjitha pjesët e nevojshme rezervë. Me vlerë 450,000 euro.
11. Transformator i Shërbimit të Stacionit të tipit të thatë-1 (IEC 60076-11:2004) me nr. KT-15-3793, prodhuar nga ELTAS – Turqi në vitin 2016 e vendosur në katin e hyrjes së termocentralit. Me vlerë 30,417.71 euro.
12. Transformator i Shërbimit të Stacionit të tipit të thatë-2 (IEC 60076-11:2004) me nr. KT-15-3792, prodhuar nga ELTAS – Turqi në vitin 2016 e vendosur në katin e hyrjes së termocentralit. Me vlerë 30,417.71 euro.
13. Gjenerator Dizel (AD 410) me nr. EAZ0B516063, prodhuar nga AKSA – Turqi në vitin 2016 e vendosur në katin e hyrjes së termocentralit. Me vlerë 38,487.16 euro.
14. Sistemi i mbrojtjes nga zjarri i furnizuar nga Alstrom Turqi në vitin 2014 i vendosur në godinën e kontrollit të termocentralit. Me vlerë 98,768.56 euro.
15. Pajisjet e tensionit të mesëm të furnizuara nga Alstom Turqi në vitin 2014 të vendosura në sallën e tensionit të mesëm të termocentralit duke përfshirë të gjitha pjesët e nevojshme rezervë. Me vlerë 683,695.40 euro.
16. Ndërprerës 220kV prodhuar nga Alstom Francë në 2015, SN AN72/2015 i vendosur në sallën GIS të termocentralit duke përfshirë të gjitha pjesët e nevojshme rezervë. Me vlerë 2,565,480.76 euro.
17. Sistemi lokal i kontrollit të procesit i furnizuar nga Alstrom Turqi në 2015 i vendosur në sallën e gjeneratorit, sallën e turbinës dhe dhomën DCS të termocentralit. Me vlerë 967,852.44 euro.
18. Sistemi i sondës së nivelit i furnizuar nga Alstom Turqi në 2015 i vendosur në rezervuarin, bazën e vendosjes, rezervuarin e mbitensionit dhe kanalin e ujit të bishtit të termocentralit. Me vlerë 19,056.55 euro.

19. Sistemet ndihmëse AC dhe DC të furnizuara nga Alstrom Turqi në 2015 të vendosura në dhomën AC/DC të termocentralit duke përfshirë të gjitha pjesët e nevojshme rezervë. Me vlerë 848,465.34 euro.
20. Pajisjet e dhomës së kontrollit të furnizuara nga Alstom Turqi në vitin 2015 të vendosura në dhomën e kontrollit të termocentralit. Me vlerë 169,142.85 euro.
21. Pajisje telekomunikacioni dhe telembrojtjeje të furnizuara nga Alstom Turqi në vitin 2015 të vendosura në sallën GIS të termocentralit. Me vlerë 157,374.32 euro.

## **VLERA E MBETUR PËR HEC FANG**

### **Vlera totale: 575,000 euro:**

1. Turbinë Horizontale e tipit Francis me nr. 2015-67, prodhuar nga CKD Holding – Republika Ceke në vitin 2015, e vendosur në sallën e turbinave të centralit elektroenergjitike duke përfshirë të gjitha pjesët plotësuese të turbinës si kutia spirale, tubi i rrymës, lidhja e çmontimit, etj.
2. Valvula flutur DN600, PN 10, me SN 116-166-7087 i prodhuar nga ARMATURY Group dhe furnizuar nga CKD Holding – Republika Ceke, ndodhet në katin e turbinës.
3. Gjenerator sinkron GS0120H1000LV, prodhuar nga TES VSETIN s.r.o CZ me SNZ1520795, i vendosur në dysheën e turbinës së energjisë.
4. Vaj i transformatorit të energjisë i zhytur 1250 KVA, Transformator i mbyllur hermetikisht i prodhuar nga ULUSOY Electric me SN 2838 në vitin 2017 i vendosur në brendësi të centralit.
5. Vaji i transformatorit të energjisë i zhytur 50 KVA, Transformator i mbyllur hermetikisht i prodhuar nga ULUSOY Electric me SN 2837 në 2017 i vendosur në brendësi të centralit.
6. Kabina të tensionit të mesëm 36 kV të prodhuara nga ULUSOY Electric në vitin 2017 të vendosura në katin e hyrjes së energjisë elektrike.
7. Të gjitha pajisjet ndihmëse duke përfshirë pompat, këmbyesit e nxehtësisë, filtrat, valvulat e kontrollit të prodhuara në vitin 2015 dhe të furnizuara nga CKD Holding – Republika Ceke, të vendosura në katin e turbinës së centralit.
8. Sistemi i automatizimit i furnizuar nga Kontrolmatik & ABB, i vendosur në katin e hyrjes së centralit.
9. Sistemet ndihmëse AC dhe DC të furnizuara nga Kontrolmatik & ABB në vitin 2015 të vendosura në katin e hyrjes së energjisë elektrike.
10. Gjenerator Diesel 55 KVA i furnizuar nga FMT Group, në vitin 2017 me GENSET id GEN01-2017DEC01, i vendosur në anë të rrymës.

## LISTA E PASURIVE TË TË PALUAJTSHME

**Vlera totale: 15,977.370 lekë:**

1. Tokë "Arë", me vlerë 642,000 lekë
2. Tokë "Arë", me vlerë 3,424,000 lekë
3. Tokë "Truall", me vlerë 889,900 lekë
4. Tokë "Arë", me vlerë 449,400 lekë
5. Tokë "Arë", me vlerë 449,400 lekë
6. Tokë "Arë", me vlerë 474,224 lekë
7. Tokë "Arë", me vlerë 1,313,960 lekë
8. Tokë "Arë", me vlerë 474,224 lekë
9. Tokë "Arë", me vlerë 1,313,960 lekë
10. Tokë "Arë", me vlerë 470,800 lekë
11. Tokë "Arë", me vlerë 473,424 lekë
12. Tokë "Arë", me vlerë 920,200 lekë
13. Tokë "Arë", me vlerë 473,424 lekë
14. Tokë "Arë", me vlerë 473,424 lekë
15. Tokë "Arë", me vlerë 449,000 lekë
16. Tokë "Arë", me vlerë 683,944 lekë
17. Tokë "Arë", me vlerë 403,176 lekë
18. Tokë "Arë", me vlerë 753,060 lekë
19. Tokë "Arë", me vlerë 1,200,000 lekë
20. Tokë "Arë", me vlerë 122,925 lekë
21. Tokë "Arë", me vlerë 122,925 lekë